

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7028  
E hënë, 23 tetor 2023  
Çmimi 0.50

Ish-kryeministri  
Berisha akuzohet për  
korrupsion, i ndalohet  
dalja jashtë vendit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## EMISARËT PERËNDIMORË KËRKOJNË THEMELIMIN E ASOCIACIONIT PA VONESË | FAQE 4-5



I dërguari i posaçëm evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ai amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, si dhe këshilltari i presidentit francez, Emmanuel Macron, ai i kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe i kryeministres italiane Giorgia

Meloni, zhvilluan takime në Prishtinë dhe në Beograd. Ata theksuan se presin që Kosova dhe Serbia t'i përmbushin detyrimet e tyre nga dialogu. Sipas tyre, ngjarjet e 24 shtatorit në veri nuk e ndryshojnë faktin që Kosova dhe Serbia kanë hyrë në marrëveshje

në rrugën e normalizimit më herët këtë vit. Emisarët perëndimorë theksuan nevojën për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë pa vonesë, duke pohuar se pa këtë nuk do të ketë përparim në rrugën e Kosovës drejt integrimit evropian

### AKTUALE



SHBA-ja DËRGON SISTEME TË MBROJTJES KUNDËRAJRORE NË LINDJEN E MESME | F. 2

RRITET NUMRI I PACIENTËVE ME GRIP SEZONAL | F. 6

PROFESORI NGA AUSTRALIA PO KRYEN OPERACIONE TË KOMPLIKUARA TE FËMIJËT NË QKUK | F. 6

### EKONOMI



NDOTJA E BADCIT ME MANGAN: ÇFARË E SHKAKTOI DHE ÇFARË PASOJASH MUND TË KETË? | F. 8

ISH-GVERNATORI I BQK-së: PËRQINDJA MË E MADHE E REMITENCAVE SHKOJNË PËR KONSUM | F. 8

### SPORT



DRITA FITON DERBIN NË 'ZAHIR PAJAZITI' | F. 10

QEVERIA: NGA KY VIT SHKOLLOR ARSIMI DUAL ËSHTË ZGJERUAR NË 12 PROFILE PROFESIONALE | FAQE 3



DEPUTETJA BRITANIKE THOTË SE DO TA PËRKRAHË KOSOVËN | FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Skenarët e mundshëm për Gazën e pasluftës

**GAZA, 22 TETOR** - Bashkëjetesa edhe ashtu jo e lehtë midis Izraelit dhe Hamasit për më shumë se 16 vjet nuk do të mund t'i mbijetojë konfliktit aktual.

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, është zotuar se do ta zhdukë nga faqja e dheut grupin militant. "Pamjet e shkatërrimit dhe rrënimin të bastioneve të Hamasit në Gazë janë vetëm fillimi. Kemi vrarë qindra terroristë. Dhe nuk do të ndalemi me kaq. Çdo vend ku vepron Hamas do të bëhet gërmadhë", ka thënë ai.

Grupi militant palestinez i Hamasit ka nisur një sulm të paprecedentë kundër Izraelit më 7 tetor, duke vrarë më shumë se 1 400 njerëz dhe duke marrë qindra pengje.

Së paku 3 300 njerëz janë vrarë deri më tash në Gazë, pasi Izraeli ka filluar sulmet ajrore hakmarrëse në të njëjtën ditë, dhe pritet ta nisë edhe ofensivën tokësore.

Izraeli, po ashtu, ka rrethuar enklavën me 2.2 milionë banorë, duke bllokuar pjesën më të madhe të furnizimeve me ushqime, ujë dhe energji elektrike.

Shumica e spitaleve atje nuk funksionojnë, ndërsa disa prej tyre janë dëmtuar keq edhe nga shpërthimet. Së paku 500 njerëz janë raportuar të vrarë vetëm mbrëmjen e 17 tetorit, kur një shpërthim ka goditur spitalin Al-Ahli Arab të mbushur plot.

Hamasit - grup i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera - ka sunduar Gazën nga viti 2007. Ai është betuar për shkatërrimin e Izraelit dhe dëshiron ta zëvendësojë atë me një shtet islamik. Ai ka zhvilluar disa luftëra me Izraelin prej se ka marrë pushtetin, të cilat kanë përfunduar me një lloj paqeje të brishtë.

Por, kësaj radhe është ndryshe - ky

nuk është thjesht një raund tjetër me Hamasin, thotë për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë", Susannah Heschel, ligjëruese e studimeve hebraike në Kolegjin Dartmouth, në Nju Hempshir. "Hamasit ka kryer sulmet më të tmerrshme kundër një kombi sovran që nga 11 shtatori [i vitit 2001], ndoshta. Dhe, krahasuar me madhësinë e popullsisë, do të thosha se kërdua e Hamasit ndaj izraelitëve i tejkalon sulmet e 11 shtatorit [në ShBA]. Pra, kjo ishte një katastrofë në çdo aspekt të qenies njerëzore", thotë Heschel.

Pamjet e Hamasit duke masakruar familje izraelite dhe duke rrëmbyer fëmijë i kanë dhënë fund status quo-së së deritashme, thotë edhe Nimrod Goren nga Instituti për Lindjen e Mesme. Duke folur për "Exposenë" nga Jerusalem, ai i përshkruan veprimet e grupit si "terroriste" dhe të papara ndonjëherë. "Numër aq të madh njerëzish të vrarë, të plagosur ose të rrëmbyer, Izraeli nuk ka pasur kurrë që nga themelimi i tij. Sulmi është i paprecedentë. Dëmi është enorm. Çdo izraelit njih dikë që është vrarë, është plagosur ose është marrë peng. Është shumë personale. Pra, është diçka me përmasa krejtësisht ndryshe", thotë Goren.

Se çfarë do ta zëvendësonte status quo-në e deritashme, është vështirë të parashikohet, thonë analistët. Sipas tyre, marrëdhëniet e ardhshme Izrael - Gazë do të mund të varen edhe nga ajo që mbetet prej Hamasit dhe Gazës kur luftimet të mbarojnë.

Vetë zyrtarët izraelitë nuk duket se janë të gatshëm për t'i diskutuar mundësitë publikisht. Ministria për Inteligjencë e Izraelit, Gila Gamliel, ka thënë për mediet: "Duhet të shohim se sa kohë do të



duhet për ta shkatërruar Hamasin. Dhe, atëherë, besoj se do të ketë një mirëkuptim ndërkombëtar me Izraelin për ditën e nesërme. Por, tani, ne duhet ta përqendrojmë të gjithë fuqinë tonë për ta fituar këtë luftë".

Hamasit "do ta paguajë çmimin dhe do ta mbajë mend", ka thënë Netanyahu. Prapa këtij qëllimi duket se qëndron edhe publiku izraelit. "Ndihem sikur jemi mjaft të fortë dhe po marrim mbështetje ndërkombëtare. Do t'i mundim armiqët tanë, do t'i luftojmë. Ata nuk do të kenë kurrë më aftësi për të bërë diçka të tillë", ka thënë Livia Shuwaks, banore e Tel Avivit, për agjencinë e lajmeve "Reuters". "Nuk dua të them gjëra si këto, por mendoj se Gazës i duhet t'i pastrojë të gjithë ata. Nuk më takon mua t'i them këto gjëra, por

nuk kemi zgjidhje tjetër", ka thënë bashkëqytetarja e saj, Nicol Mori. Ekspertët thonë se edhe nëse Izraeli vret çdo udhëheqës të Hamasit në Gazë, shkatërrimi i organizatës mund të jetë misioni i pamundur. Sipas tyre, Hamasit është një ideologji që ka mbështetës gjetu - nga Libani në Katar.

Goren, nga Instituti për Lindjen e Mesme, thotë se vakuumi që do të linte rrëzimi i këtij grupi nga pushteti, do të duhej të plotësohej nga një organ qeverisës që do ta rindëronte enklavën e shkatërruar.

Perëndimi i ka shprehur mbështetje Izraelit në luftën e tij kundër Hamasit. "Nuk jeni vetëm", ka qenë mesazhi i presidentit amerikan, Joe Biden, gjatë qëndrimit të tij në Tel Aviv

më 18 tetor.

Analistët thonë se dhuna në mes të Izraelit dhe Hamasit ka të ngjarë të përshkallëzohet në javët e ardhshme, por se ajo nuk do të përcaktojë se kush do ta fitojë luftën. Fituesi do të përcaktohet në tryezën e bisedimeve, thonë ata.

Sipas Institutit Ndërkombëtar për Studime Strategjike, Izraeli ka 169 000 ushtarë aktivë, ndërsa brigadat e Hamasit deri në 20 000. Izraeli, po ashtu, beson se Hamasit, i mbështetur nga Irani, ka armatim të fuqishëm, përfshirë raketa anti-tank.

Rrjedhën e luftës mes tyre me ankh janë duke e përcjellë edhe vendet fqinje, ndërkohë që dy aeroplanmbajtëse amerikane janë dërguar tashmë në Mesdheun lindor.

## ShBA-ja dërgon sisteme të mbrojtjes kundërajrore në Lindjen e Mesme

Uashington, 22 tetor - Shtetet e Bashkuara njoftuan të dielën se do të dërgojë mjete shtesë ushtarake në Lindjen e Mesme për shkak të drujtjeve se lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit mund të përhapet në tërë rajonin.

Pentagoni tha se do ta çojë sistemin e mbrojtjes kundërajror të njohur si THAAD, bashkë me sistemin raketor tokë-ajër, Patriot, në Lindjen e Mesme.

Sistemi THAAD është i ndërtuar për të rrëzuar raketa balistike me reze të shkurtra dhe të mesme veprimi pak para se ato të bien në tokë.

Sekretari i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara, Lloyd Austin, tha se trupa shtesë janë vënë, po ashtu, në gjendje gatishmërie për t'u zhvendosur në rajon, edhe pse nuk tregoi sa prej tyre.

Izraeli i vazhdoi bombardimet në



Gazë edhe të dielën, duke i vrarë rreth 50 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës.

Ushtria e Izraelit kreu sulme ajrore

edhe në shtetin fqinj, Siri, duke i vrarë dy civilë, sipas medieve shtetërore siriane.

Për më tepër, Izraeli tha se avionët e vet luftarakë i goditën caqet e

Hezbollahit në Liban të shtunën dhe se njëri nga ushtarët e vet u godit nga një raketë anti-tanke gjatë luftimeve përgjatë kufirit ku u vranë gjashtë ushtarë të grupit të


mbështetur nga Irani.

Sekretari i Shtetit i ShBA-së, Antony Blinken, e paralajmëroi të shtunën kryeministrin në detyrë të Libanit, Najib Mikati, se libanezët do të prekën nga lufta nëse vendi i tij përfshihet në të.

Izraeli e nisi rrethimin e plotë të Gazës dhe bombardimet ndaj saj më 7 tetor, pasi militantët e Hamasit e kaluan kufirin dhe nisën sulmet e tërbuara në jug të Izraelit, duke i vrarë 1 400 njerëz, kryesisht civilë.

Ministria e Shëndetësisë e Gazës tha të shtunën se së paku 4 385 palestinezë janë vrarë, përfshirë qindra fëmijë, si pasojë e bombardimeve hakmarrëse izraelite në territorin e vogël me rreth 2.3 milionë banorë, gjysmë e të cilëve janë detyruar të zhvendosen nga veriu në jug të Gazës.

## Deputetja britanike thotë se do ta përkrahë Kosovën


**EPOKA E RE**
**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 22 TETOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka përsëritur, gjatë një takimi me deputeten britanike Alicia Kearns të dielën, se Serbia duhet të ndëshkohet për sulmin e muajit të kaluar në veri të Kosovës "në mënyrë që të mos e përsërit atë më".

Në një njoftim për media të dielën, Qeveria e Kosovës tha se në takim në mes të Kurtit dhe Kearnsit "u theksua që prioritet kryesor për Republikën e Kosovës është siguria e shtetit dhe e qytetarëve". "Pas sulmit terrorist dhe kriminal të 24 shtatorit të kryer nga grupe paramilitare me sponsorim dhe pjesëmarrje të Serbisë, ndëshkimi është vendimtar për mospërsëritje", tha Kurti.

Rreth dy muaj para sulmit ndaj Policisë së Kosovës nga një grup serbësh të armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator - ku mbeti i vrarë reshteri Afrim Bunjaku - Kearns kishte thënë se "armët po kontrabandohen në autoambulanca dhe më pas po ruhen në objektet e kishave".

Policia e Kosovës ka gjetur arsenal të jashtëzakonshëm armësh në veri pas sulmit, për të cilat tha se janë futur në Kosovë përmes Serbisë.

Kosova e ka akuzuar Serbinë se tentoi ta "aneksojë tërë veriu e

Kosovës", gjë të cilën Serbia e ka mohuar, megjithëse përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoičiq, nënkryetari i atëhershëm i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit.

Kurti, sipas njoftimit të qeverisë, shprehu edhe "përkushtimin e plotë" për zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të zbatimit të saj, që Kosova dhe Serbia i arritën në fillim të këtij viti. Kearns është takuar edhe me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeparlamentarin Glauk Konjufca.

Deputetja Kearns e falënderoi presidenten Osmani për ftesën dhe "theksoi përkushtimin e saj personal për ta vazhduar mbështetjen ndaj Kosovës, por edhe përkushtimin e Mbretërisë së Bashkuar për të punuar ngushtë për promovimin e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit", thuhet në njoftim.

Kearns, e cila është edhe kryetare e Komisionit për Punë të Jashtme në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, u prit në një takim të shtunën edhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. "Kearnsit i shpreha mirënjohjen time dhe të vendit tonë për mbështetjen e saj të madhe dhe të vendit të saj që na ka qëndruar në krah në kohët më të vështira dhe në ato më të mirat" shkroi Konjufca në "Facebook".

## Qeveria: Nga ky vit shkollor arsimit dual është zgjeruar në 12 profile profesionale

**PRISHTINË, 22 TETOR** - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të dielën se me qeverisjen nën drejtimin e tij arsimit i lartë publik është bërë falas për të gjithë sepse, sipas tij, arsimit është e drejtë e pakushtëzuar. Ai ka thënë se është duke u bërë edhe ndërlidhja e arsimit me ekonominë dhe ka bërë me dije se buxheti për arsim është rritur. "Hendeku ndërmjet aftësive profesionale dhe kërkesave të tregut është thelluar për shumë vjet me radhë. Buxheti për arsim është rritur sepse investimi në arsim është investim me kthim të sigurt. 43 mijë studentë ndjekin studimet e tyre në nivelin bachelor dhe master falas. Duke filluar nga ky vit shkollor, arsimit dual është zgjeruar në 12 profile profesionale, nga vetëm katër sosh sa ishin në vitin pararendës, në gjithsej 21 shkolla profesionale dhe 13 komuna gjithandej vendit. Arsimit dhe aftësimi profesional është një nga projektet më të mëdha të transformimit të ekonomisë sonë", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ai ka treguar se janë ndarë afër 4 000 bursa për studime brenda

dhe jashtë vendit, prej të cilave mbi 2 900 për fushat STEM, duke u dhënë vëmendje të veçantë vajzave që studiojnë këto fusha. "Pjesëmarrja e vajzave në studime në fushat STEM në Universitetin e Prishtinës aktualisht është në masën 50 %, ndërsa mesatarja e vendeve të BE-së është 17 %. Në prill të këtij viti organizuam për herë të parë konferencën 'STEMinist', kushtuar rëndësisë së përfshirjes së vajzave dhe grave në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës, që tash e tutje do të jetë pjesë e kalendarit vjetor të qeverisë. Përveç bursave në nivel të universitetit, ndamë edhe 500 bursa për nxënës të shkollave të mesme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe 400 mijë euro për mbështetjen e 21 qendrave mësimore nga të cilat më së shumti përfitojnë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë", ka bërë me dije kryeministri.

Kurti ka thënë se për edukim të hershëm ndërtoan e po rinovojnë ose adoptojnë gjithsej 31 çerdhe të reja. "Krahas rikthimit në ENQA si anëtare e asociuar, pas



përfshirjes së Agjencisë së Kosovës për Akreditim në vitin 2019, morëm statusin e asociuar në programin 'HorizonEurope' me të drejta të plota, program ky që e

mundëson bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Gjithashtu, pas një dekade rifunksionalizuam Këshillin Kombëtar të Shkencës, që

tashmë ka hartuar programin kombëtar të shkencës, i cili është dokumenti bazë për financimin e punës kërkimore shkencore në vend", është shprehur kryeministri Kurti.



# Emisarët perëndimorë kërkojnë themelimin e Asociacionit pa vonesë

I dërguari i posaçëm evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ai amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, si dhe këshilltari i presidentit francez Emmanuel Macron, i kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe i kryeministres italiane Giorgia Meloni, zhvilluan takime në Prishtinë dhe në Beograd. Ata theksuan se presin që Kosova dhe Serbia t'i përmbushin detyrimet e tyre nga dialogu. Sipas tyre, ngjarjet e 24 shtatorit në veri nuk e ndryshojnë faktin që Kosova dhe Serbia kanë hyrë në marrëveshje në rrugën e normalizimit më herët këtë vit. Emisarët perëndimorë theksuan nevojën për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë pa vonesë, duke pohuar se pa këtë nuk do të ketë përparim në rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian

**EPOKA  
ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - I dërguari i posaçëm evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ai amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, si dhe këshilltari i presidentit francez Emmanuel Macron, i kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe i kryeministres italiane Giorgia Meloni, zhvilluan takime të gjata në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në përpjekje për t'i ripërtërirë bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve. Kjo ishte përpjekja e parë që nga 24 shtatori kur një grup serbësh të armatosur kreu një sulm në fshatin Banjskë në veri të Kosovës duke vrarë një oficer policie.

Tre pjesëtarë të grupit u vranë gjatë përlshjeve me policinë, duke nxitur shqetësimin e diplomatëve perëndimorë për

qëndrueshmërinë në rajon.

Diplomatët dhe mikpritësit e tyre në Prishtinë dhe në Beograd thanë se ata paraqitën një plan për rrugën përpara, por pa dhënë hollësi. Në fund të takimit në Prishtinë u vu re një dallim mes diplomatëve perëndimorë të cilët vunë theksin tek themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe kryeministrin të Kosovës Albin Kurti, i cili vuri theksin te siguria e vendit.

I dërguari evropian Lajçak tha se ngjarjet e 24 shtatorit e kanë bërë të qartë se shtensionimi dhe normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve janë tani më urgjente se kurrë. "Çdo kusht apo vonesë është i papranueshëm dhe ne presim që Kosova dhe Serbia t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre nga dialogu. Ngjarjet e 24 shtatorit nuk e ndryshojnë faktin që Kosova dhe Serbia kanë hyrë në marrëveshje në rrugën e normalizimit më herët këtë vit", tha Lajçaku në Prishtinë,

duke nënvizuar se kryeministri Albin Kurti ka përgjegjësi të bëjë përparim në normalizimin e marrëdhënieve nëse Kosova dëshiron të përparojë drejt Bashkimit Evropian. "Dhe ne këtu e theksuam nevojën për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë pa vonesë. Pa këtë nuk do të ketë përparim në rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian. Vlerësojmë gatishmërinë e kryeministrin Kurti për t'i vazhduar së shpejti diskutimet tona", tha ai. Qeveria e Kosovës përmes një komunikate citoi kryeministrin Albin Kurti të ketë thënë se "përparësi kryesore dhe çështje urgjente për Kosovën është siguria e shtetit dhe e qytetarëve, e kufijve dhe e territorit". Sipas qeverisë, kryeministri Kurti theksoi "që është i nevojshëm reflektimi cilësor dhe një qasje e re. Të pesë emisarët ofruan planin e tyre të ri për ecjen përpara, për çfarë kryeministri shprehu falënderimet dhe vlerësimet e tij. Diskutimet

duhet të vazhdojnë intensivisht", thuhet në komunikatë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë të dielën se "qëllimi i vetëm" i Perëndimit është njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe se pret që dialogu Prishtinë - Beograd të vazhdojë kah fundi i javës së ardhshme në Bruksel.

Vuçiqi i bëri këto deklarata gjatë një adresimi publik në televizionin "Pink" mëngjesin e së dielës, një ditë pasi u takua në Beograd me pesë diplomatët perëndimorë. Ai përsëriti se takimi i djeshëm ishte "i vështirë" për të dhe se nuk mund të jepte më shumë hollësi. "Natyrisht, gjithçka rreth Kosovës është tejet e vështirë për ne. Njerëzit mendojnë se kjo është vetëm për shkak të Banjskës, por nuk është ashtu. Për ne ishte e tmerrshme në aspektin taktik dhe prodhoi pasoja të caktuara, por në kuptimin strategjik qëllimi i vetëm i tyre është që ne ta njohim Kosovën", tha Vuçiqi.

Serbia i ka mohuar akuzat e Kosovës se tentoi ta "aneksojë veriun e Kosovës" kur një grup serbësh të armatosur e sulmuan Policinë e Kosovës më 24 shtator në fshatin Banjskë të Zveçanit, duke e vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Pas takimit me Vuçiqin, përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, përsëriti se sulmuesit e policisë së Kosovës në Banjskë duhet të sillen para drejtësisë dhe

se incidenti duhet të hetohet tërësisht, si dhe i kërkoj Serbisë të bashkëpunojë në këtë çështje.

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, tha në Beograd se të dyja takimet ishin të rëndësishme dhe përgjatë tyre është shprehur shqetësimi mbi rrugën aktuale negative në procesin e normalizimit që është e lidhur me të ardhmen evropiane të Kosovës dhe Serbisë. "Le të jemi shumë të qartë që udhëheqësit kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe presim përgjegjësi dhe komunikim të matur publik. Edhe Serbia edhe Kosova duhet të bëjnë pjesën e tyre për shtensionim të situatës dhe normalizim të marrëdhënieve", tha Lajçaku pas takimit me presidentin serb.

I dërguari evropian tha se ngjarja e 24 shtatorit ishte e pashembullt, shumë serioze dhe Bashkimi Evropian do të këmbëngulë në hetimin e plotë dhe vënien e përgjegjësve para drejtësisë. Kosova akuzon Serbinë për organizimin e sulmit ndaj policisë më 24 shtator, ndërsa Beogradi zyrtar mohon çfarëdo lidhjeje me grupin e armatosur që kreu sulmin, përgjegjësinë për të cilin e mori Milan Radojčić, ish-nënkryetar i Listës Serbe, subjektit më të madh politik të serbëve në Kosovë.

Autoritetet në Kosovë thonë se procesi i dialogut duhet të rimendohet pas sulmit të 24 shtatorit, duke kërkuar sanksionimin e Serbisë dhe

# Ish-kryeministri Berisha akuzohet për korrupsion, i ndalohet dalja jashtë vendit

TIRANË, 22 TETOR - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, akuzohet për korrupsion pasiv dhe si pasojë i është ndaluar të udhëtojë jashtë vendit pas një vendimi të Prokurorisë së Posaçme të Shqipërisë (SPAK) të shtunën vonë.

SPAK-u njoftoi se ia ka caktuar Berishës masën e sigurisë "detyrim për t'u paraqitur" si dhe "ndalim të daljes jashtë shtetit".

Berisha dyshohet si pjesë e një hetimi për dyshimet për korrupsion gjatë privatizimit të kompleksit sportiv "Partizani".

Për të njëjtën çështje të shtunën u arrestua dhëndri i tij, Jamarbër Malltezi. Ai akuzohet për "korrupsion pasiv në bashkëpunim" si dhe "pastrim parash".

Sali Berisha - që aktualisht drejton grupin "Rithemelimi" brenda Partisë Demokratike - i cilësoi akuzat ndaj tij si "të pabaza dhe të motivuara politikisht" gjatë një konference për media të shtunën mërzë. "As kufizimi im për të lëvizur në Shqipëri, as kufizimi im për të lëvizur në Evropë nuk mund të ndodhte kurrë pa miratimin e komisioneve përkatës parlamentare, por këtu ku Prokuroria është thjesht një seksion i Partisë Socialiste,



mund të merret çdo vendim", tha Berisha.

Berisha nuk i pranoi në zyrën e tij zyrtarët ligjorë që kishin shkuar për t'ia kumtuar vendimin e Prokurorisë të shtunën, duke thënë se "unë nuk mund ta shkel Kushtetutën, që përcakton qartë se kufizimi i lirisë së një deputeti nuk mund

të ndodhë pa miratimin e Kuvendit".

Së bashku me Jamarbër Malltezin u arrestua edhe ortaku i tij në ndërtimin e disa kullave në zonën e ish-kompleksit sportiv, Fatmir Bektashi. Ai akuzohet për "korrupsion aktiv" dhe "pastrim parash".

Në një kallëzim të dorëzuar në

vitin 2020 në SPAK nga Taulant Balla, tani ministër i Brendshëm thuhet se, "sipas të dhënave të Agjencisë së Pronave, toka në fjalë ka qenë e pronarëve, por ajo i ka kaluar shtetit dhe në vitin 1940 ata janë dëmshpërblyer nga qeveria italiane, pasi vendi ynë ishte pushtuar nga Italia". Kompleksi sportiv "Partizani",

me një sipërfaqe prej 26 mijë metrash katrorë, u privatizua në vitin 2008, deri në atë kohë ishte pronë e Ministrisë së Mbrojtjes. Rreth 22 mijë metra katrorë u përkisnin 64 trashëgimtarëve të pesë familjeve të ish-pronarëve, mes tyre edhe Jamarbër Malltezi, ndërsa 4 000 metra katrorë të tjerë ishin pronë shtetërore. Në fund të procesit të kthimit të kësaj prone, Jamarbër Malltezi arriti të marrë 35 % të gjithë pronës, duke përfshirë këtu edhe pjesën që ishte tokë shtetërore.

Sipas padisë së dorëzuar në SPAK, kjo është bërë përmes vendimeve të dyshimta të qeverisë së Sali Berishës. Në atë sipërfaqe të përfituar, Jamarbër Malltezi së bashku me ortakun e tij, Fatmir Bektashi, kanë ndërtuar disa kulla.

Për këto ndërtime, në kallëzimin e dorëzuar në prokurori, theksohet se nuk dihet burimi i të ardhurave. Për këtë çështje janë thirrur në SPAK disa ish-ministra të Mbrojtjes dhe të Ekonomisë nga qeveria e atëhershme e Berishës.

Ish-kryeministri Sali Berisha dhe familja e tij, përfshirë edhe dhëndrin Jamarbër Malltezi, janë shpallur persona të padëshiruar (non grata) nga Shtetet e Bashkuara, nën dyshimet se janë të përfshirë në korrupsion të lartë dhe cenim të demokracisë.



përparësinë që duhet t'i jepet sigurisë në Kosovë. "Dialogu është më i rëndësishëm se kurrë, sepse nëse nuk ka dialog mund të përsëritet përshkallëzimi dhe kjo nuk është çka duam ne, as çka doni ju. Prandaj jemi këtu. E dyta, nuk ka alternativë tjetër pos

dialogut, sepse dialogu sjell normalizim e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe e hap rrugën evropiane për Kosovën dhe Serbinë", tha i dërguari evropian Miroslav Lajçak, i cili u takua të shtunën për herë të parë me kryeministrin Kurti që nga

raundi i fundit i bisedimeve Kosovë - Serbi në Bruksel që u mbajt më 14 shtator, pas të cilit kryeministri Kurti e kritikoi atë për qasje "të njëanshme".

Fuqitë perëndimore kërkojnë që Kosova dhe Serbia të zbatojnë një marrëveshje për të cilën palët u

pajtuan në muajin shkurt dhe mars në Bruksel dhe në Ohër për rrugën drejt normalizimit.

Udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian në takimin e lartë të mbajtur të premten në Uashington përmes një komunikate theksuan,

siç thanë, nevojën që Kosova dhe Serbia t'i shtensionojnë urgjentisht tensionet dhe ta zbatojnë me shpejtësi dhe pa kushte marrëveshjen në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve të tyre dhe kthimin në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian.

## Pastrohen rrugët në hyrje-dalje të Prishtinës

PRISHTINË, 22 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar të dielën se rrugët e kryeqytetit janë pastruar. Rama ka shkruar në "Facebook" se rrugët hyrëse "u fshinë e lanë me ujë". "Drejtori i Shërbimeve Publike, Ilirik Musliu, bashkë me zyrtarët e drejtorisë, sot

filluan aksionin e pastrimit të hyrjeve të Prishtinës, e në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, u dakorduan që fundjavave të bëhet një pastrim i tillë", ka shkruar Rama. Ndërkaq drejtori i Shërbimeve

Publike, Ilirik Musliu, ka thënë se sot ishte një super ditë. Edhe Musliu ka njoftuar për dakordimin me MMPHI-n që edhe në javët e tjera të ketë mobilizime të tilla për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale që ndërlihen me hyrjet/daljet e kryeqytetit.



## Musliu ngre dyshimet që Serbia po furnizohet me dronë nga Irani



PRISHTINË, 22 TETOR - Drejtori i Institutit "Octopus", Agim Musliu, ka ngritur dyshime se Serbia po furnizohet me dronë nga Irani. Musliu ka shpërndarë një postim ku thuhet se një avion që lidhet me kompaninë "Pouya Air", e cila është e lidhur me Gardën Revolucionare Islamike Iraniane, është parë mbi ajër në Turqi dhe se destinacion duhet të jetë

Beogradi. "Çfarë është kjo, a po blen vërtet Serbia dronë nga Irani", ka shkruar Musliu. Institutit "Octopus" para disa javësh ka prezantuar në Prishtinë një analizë rreth sulmit terrorist që ndodhi më 24 shtator në Banjskë të Zveçanit. Në analizën e përpiluar nga Institutit "Octopus" theksohet se Serbia punon aktivisht për krijimin e botës serbe, ide e

mbështetur nga Kisha Ortodokse serbe dhe Akademia serbe e Shkencave dhe Arteve, si dhe e risjell në vëmendje së fundmi nga Aleksandar Vulin, duke shprehur haptazi ambicet territoriale dhe idenë e shkatërrimit të disa shteteve të rajonit, nga ku më të rrezikuarat vazhdojnë të mbeten Kosova, Mali i Zi si dhe Bosnjë-Hercegovina.

## "Lëvizja për braktisjen e fesë islame" në Deçan, reagon Këshilli i Bashkësisë Islame

Prishtinë, 22 tetor - Këshilli i Bashkësisë Islame në Deçan ka reaguar lidhur me formimin e "Lëvizjes për braktisjen e fesë islame". Në një reagim të publikuar në "Facebook", KBI në Deçan ka shprehur indignatën lidhur me formimin e kësaj lëvizje, derisa thekson se kjo lëvizje nuk ka qëllime të mira dhe se "aty vërehen elemente përçarëse dhe nxitje

të urrejtjes ndërfaqetare". "Ju kujtojmë se populli ynë me besimin islam dhe besimet e tjera ka ditur të ruajë dhe kultivojë paqen dhe tolerancën ndërfaqetare, fakt i çmuar shumë përgjatë historisë sonë. Mbështetur në këtë fakt, lëvizjet e tilla kanë tendencë qëllimkëqija dhe atakojnë atmosferën e shkëlqyeshme të ndërtuar me

shkuj te ne, sepse me këtë veçanërisht sulmohet islami", thuhet në reagimin e KBI-së në Deçan. KBI-ja në Deçan u ka bërë thirrje qytetarëve "që mos të bien pre e manipulimeve të tilla, as përçarjeve të tilla". Për formimin e kësaj lëvizje kishte reaguar edhe Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Dega në Deçan.



## Rritet numri i pacientëve me grip sezonal



PRISHTINË, 22 TETOR - Temperatura e lartë, dhimbja e fytit, kollitja, vjellja dhe lodhja janë disa nga simptomat që e karakterizojnë gripin sezonal, për çka është rritur edhe fluksi i qytetarëve që kërkojnë ndihmë mjekësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare në Prishtinë. Kështu ka bërë me dije mjekja e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, Violeta Haxhija, e cila thotë se personat më të rrezikuar nga gripin sezonal janë fëmijët, personat mbi 65 vjeç, personat me sëmundje kronike të zemrës, mushkërive, me

hipertension, si dhe gratë shtatzëna. "Kemi një fluks të rritur nëpër qendrat tona të pacientëve që kërkojnë ndihmë mjekësore nga simptomat e gripit sezonal. Ky është një infeksion akut viral që shkaktohet nga virusi i influencës apo virusi i gripit i tipit A dhe B, që janë më të shpeshta. Simptomat e gripit sezonal janë kollitje, temperaturë e lartë, lodhje, plogështi, dhimbje e nyjave, dhimbje e fytit, dhimbje e barkut, vjellje, diarre. Mirëpo, ne i kemi edhe disa simptoma më të rrezikshme që janë te fëmijët,

për shembull nëse kemi vështirësi në frymëmarrje, skuqje të lëkurës, shtangim të qafës, vjellje pa ndërprerë, mosmarrje e lëngjeve, duhet menjëherë të lajmërohen te mjeku familjar", ka thënë Haxhija. Mjekja Haxhija tha se shenjat e rrezikut për të rriturit nga ky grip janë dhimbjet e gjoksit, kraharorit, pengesa në frymëmarrje dhe konfuzion, për çka u shpreh se menjëherë duhet të merret trajtim mjekësor. Lidhur me furnizimin e listës esenciale të barnave ajo tha se qëndrojnë mirë. (kp)

## Profesori nga Australia po kryen operacione të komplikuar te fëmijët në QKUK

PRISHTINË, 22 TETOR - Për herë të dymbëdhjetë profesori dhe humanisti Paddy Dewan nga Australia, bashkë me ekipin e mjekëve nga Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve dhe Anesteziologjisë, po kryejnë operacione te fëmijët që kanë

anomali të lindura kirurgjike komplekse, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës. Sipas këtij njoftimi, ky ekip ka kryer operacione dhe konsultime edhe gjatë fundjavës, kurse në tërësi do të operohen 19

fëmijë, kurse janë konsultuar-vizituar 32 fëmijë me probleme kirurgjike. Ekipi i udhëhequr nga profesori nga Australia ka ardhur në Kosovë më 18 tetor dhe do të qëndrojë deri më 25 tetor 2023.



## Ndotja e Badocit me mangan: Çfarë e shkaktoi dhe çfarë pasojash mund të ketë?

PRISHTINË, 22 TETOR - Rreth 18 kilometra rrugë e ndajnë qendrën e Prishtinës nga Liqeni i Badocit, nga i cili bëhet furnizimi me ujë të pijshëm. Ky liqen artificial ishte ndërtuar në vitet '60 për ta furnizuar me ujë qytetin e Prishtinës. Por, më 19 tetor, sasia e madhe e detektuar e elementit kimik, mangan, bëri që Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) të kërkojë nga qytetarët që furnizohen me ujë nga fabrika e ujit të këtij liqeni, të mos e përdorin atë për pije dhe gatim.

### Çfarë e shkaktoi sasinë e ngritur të manganit në Liqenin e Badocit?

Vlerat e shtuara të manganit në ujin e Liqenit të Badocit vijnë si pasojë e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë, thotë eksperti i ujërave Skënder Bublaku. Ai thotë se si "liqen relativisht i vjetër" janë disa faktorë që bëjnë që në Liqenin e Badocit të mund të shfaqet herë pas here mangan në vlera më të larta.

"Ajo është një zonë relativisht e pasur me minerale. Liqeni e ka pasur një problem teknik prej fillimit, marrja e ujit bëhet relativisht ulët, afër fundit të liqenit. Dhe kjo e bën gjithmonë problematike praninë e metaleve në tokë në krahasim me liqenet e tjera", thotë Bublaku për "Radion Evropa e Lirë".

Bublaku thotë se për t'u zgjidhur ky problem, Kosova duhet të investojë në atë mënyrë që të "mundësohet ndërimi i marrjes së ujit nëpër nivele të ndryshme të liqenit". Por, derisa të bëhet një investim i tillë, ai paralajmëron se duhet të bëhet më shumë kujdes. "Aktivitetet njerëzore duhet të reduktohen për shkak se në kuptimin natyror ky liqen është pak më i rrezikuar si pasojë e përbërjes gjeologjike të tokës", thotë Bublaku.

Ambientalistja Valbonë Mustafa ka tentuar disa herë ta zhbëjë një dëm të shkakuar nga njerëzit përreth këtij liqeni duke hequr mbeturina. Bashkë me një grup ambientalistësh ajo ka pastruar katër herë liqenin dhe ka

shpërndarë në rrjete sociale rezultatin: grumbuj thasësh të mbushur përplot me mbeturina. "Radio Evropa e Lirë" ka pyetur IKShPK-në lidhur me shkaqet që kanë çuar në ngritjen e nivelit të manganit dhe rreziqet që mund t'i sjellë ai, por nuk ka marrë përgjigje deri në publikimin e këtij artikulli.

### Çfarë problemesh mund të sjellë sasia e madhe e manganit në ujë?

Bublaku thotë se mangani "shfaqet pothuajse në të gjitha resurset dhe aty ku nuk i kalon vlerat, nuk është problematik". "Pra, mangani është shfaqur edhe më herët, do të shfaqet edhe më vonë, por varet se sa është përqendrimi i tij në ujë", thotë Bublaku.

Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mangani është një element esencial për shumë gjallesa, përfshirë këtu edhe njerëzit. Por, "efekte të padëshirueshme në shëndetin e njerëzve mund të shkaktohen nga marrja e

pamjaftueshme ose ekspozimi i tepërt [ndaj manganit]".

Departamenti qeveritar i Kanadasë për Shëndetësi, Health Canada, thotë se mënyra më e lehtë e absorbimit të këtij elementi është përmes ujit të pijes. Por, ky departament shton se nëse uji që ka nivele më të larta të manganit sesa që lejohet, e që konsumohet vetëm për periudha të shkurtra kohore, "nuk ka gjasa të shkaktohet ndonjë problem shëndetësor". E nëse pirja e ujit të kontaminuar me nivele më të larta të manganit bëhet për një periudhë më të gjatë kohore, atëherë mund të shfaqen probleme shëndetësore.


"Fëmijët dhe të rriturit që pinë ujë me nivele të larta mangani për një kohë të gjatë, mund të kenë probleme me kujtesë, përqendrim dhe aftësi motorike. Foshnjat (nën një vjeç) mund të kenë probleme të të mësuarit dhe sjelljes nëse pinë ujë me shumë mangan në të", thuhet në uebfaqen e Departamentit të Shëndetësisë në Minesota të ShBA-së.

IKShPK-ja nuk ka treguar se

për sa kohë mund të ketë ekzistuar ky problem me nivele më të larta të manganit në ujë dhe se në çfarë niveli ka qenë përqendrimi i këtij elementi.

### Problemet e mëhershme me ujë

Edhe në të kaluarën banorëve të Kosovës u është kërkuar të mos e pinë ujin e ujësjellësit, veçanërisht kur ka pasur vërshime. Vitin e kaluar rreth 450 qytetarë të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit kanë kërkuar ndihmë mjekësore pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore nga pirja e ujit të ujësjellësit që ka pasur nivel të lartë të baktereve. Në atë kohë, Burbuqe Nushi nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka thënë për REL-in se në disa prej fshatrave të asaj zone ujësjellësi nuk është në menaxhim të askujt. E ndërkohë, në vitin paraprak, më 2021, rreth 1 600 qytetarë të Deçanit kanë kërkuar ndihmë mjekësore shkak i ujit të konsumuar.



## Ish-guvernatori i BQK-së: Përqindja më e madhe e remitencave shkojnë për konsum

PRISHTINË, 22 TETOR - Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se përqindja më e madhe e remitencave shkojnë për konsum, ndërsa një pjesë tjetër për investime të huaja direkte. Mehmeti i vlerëson lart investimet që i bën diaspora sidomos në patundshmëri teksa rol kyç thotë se luajnë edhe në turizëm, kohë kur diaspora viziton Kosovën. Duke folur për shifrat që diaspora i dërgon në Kosovë përmes kanaleve bankare, Mehmeti thotë se e

kalojnë shifrën e 1 miliard eurove. Sipas Mehmetit, nga 1.2 miliard euro që ishin vitin e kaluar, 896 milionë euro kanë shkuar në konsum, teksa thotë se kjo e financon deficitin tregtar. Kurse këtë vit deri në korrik kanë shkuar deri në 443 milionë euro. "... remitencat në shumë aspekte ndikojnë pozitivisht në Kosovë nëse i marrim në aspektin e konsumit. Konsumi ndikon pozitivisht dhe kryesisht 1.2 miliard ka qenë në vitin 2022, 896 milionë ka qenë deri në korrik 2023, kryesisht të ndikuara

në konsum dhe kjo e financon deficitin tregtar, rrit mirëqenien e qytetarëve. Nëse i shohim edhe si investime, remitencat janë një faktor shumë i rëndësishëm për arsye se 443 milionë euro ishin investimet e huaja direkte në Kosovë, pra deri në korrik 2023 e që kryesisht shkojnë në patundshmëri, në blerje të tokave dhe banesave, por nëse i shohim edhe në aspektin e turizmit, është një prej atyre faktorëve që diaspora e rrit edhe në këtë aspekt", thotë Mehmeti. (EO)



# Qeveria e Kosovës abuzoi me besimin e ShBA-së



Uashington, 7 qershor - Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës. Kështu ka thënë ish-ndihmës i sekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Fried.

Sipas tij, SHBA-ja nuk ka qenë kurrë kaq e zemëruar me Qeverinë e Kosovës dhe një gjë e tillë është "mjaf shqetësuese".

Kryeministri Albin Kurti dhe ekipi i tij "e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë", ka thënë Fried në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".

Reagimi vjen pas kritikave të ashpra që bëri i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në adresë të Kurtit, të cilin e ka fajësuar për mungesë bashkëpunimi në shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Tensionet në këtë pjesë të vendit, të banuar me shumicë serbe, janë të larta qysh më 26 maj, kur kryetarët shqiptarë të komunave kanë marrë detyrën, përkundër rezistencës së banorëve lokalë.

Zoti Fried, i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ishte shumë kritik ndaj Qeverisë së Kosovës për situatën e tensionuar në veri të vendit. Ai e kritikoi kryeministrin Albin Kurti për mungesë bashkëpunimi në uljen e tensioneve. Kurti, në anën tjetër, këmbëngul se nuk mund të bëjë kompromise për "republikën demokratike". Cili është komenti

juaj?

Daniel Fried: Është e qartë që Kosova është duke i injoruar shqetësimet e Shteteve të Bashkuara dhe duke vepruar në një mënyrë që ne nuk e inkurajojmë. Unë kurrë nuk e kam parë administratën e SHBA-së kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës, jo në këta 15 vjet që nga shpallja e pavarësisë.

Qeveria amerikane i ka inkurajuar kosovarët që të mos e bëjnë këtë problem në veri dhe kosovarët na kanë injoruar. Dhe, rezultatet janë pikërisht ato për të cilat i kemi paralajmëruar. Unë nuk kam dyshim në supozimet e mia. Përndryshe nuk mund ta shpjegoj se përse ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, dhe Gabriel Escobar do të ishin aq të irrituar. Unë supozoj se ata i kanë arsytet e tyre. Unë supozoj se arsytet e tyre bazohen në injorimin që u bëri Kurti paralajmërimeve të tyre dhe në të konsideruarit e mbështetjes së ShBA-së si të mirëqenë – çfarë ka qenë gabim dhe e habitshme.

Ai (Kurti) e ka bërë presidentin e Serbisë, (Aleksandër) Vuçiq të duket empatik. Nuk kam menduar se kjo është e mundur, marrë parasysh se serbët janë burim i problemit, sepse janë ata që refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës dhe refuzojnë ta njohin realitetin se Serbia nuk do ta ketë më kurrë (Kosovën). Por, pavarësisht kësaj, Kurti ka arritur t'i dëmtojë marrëdhëniet me SHBA-në për asnjë interes që unë mund ta identifikoj. Është mjaf

shqetësuese. Unë nuk e kam parë kurrë Qeverinë amerikane kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës.

Pra, mendoni se Kurti po shkon shumë larg në rrethanat aktuale... Daniel Fried: Po, mendoj se ka bërë gabim në gjykimet. Ai e definon sovranitetin e Kosovës në atë mënyrë që e bën të ndihet se mund të kërkojë asgjë tjetër, përveç maksimumit. Dhe, duke vepruar kështu, ai e ka bërë situatën e keqe edhe më të keqe.

Escobari, duke folur për masat kundër Kosovës nëse Kurti nuk është konstruktiv, tha se ShBA-ja "nuk mund të planifikojë asgjë për Kosovën"... Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Daniel Fried: Mendoj se ai po shpreh zhgënjimin e administratës [amerikane] me Kurtin dhe po e bën të qartë se Kurti dhe ekipi i tij e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë, por më mirë të nisim e ta bëjmë një gjë të tillë. E përsëris, burimi afatgjatë i problemit në marrëdhëniet Kosovë-Serbi vjen nga Beogradi, nga revanshizmi serb, ndërsa Kurti ka arritur të grindet me ShBA-në. Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës në atë mënyrë që unë s'e kuptoj. Unë nuk e di se çfarë ka menduar ai (Kurti).

Escobari, po ashtu, e ka bërë të qartë se kjo situatë nuk ka të bëjë me popullin e Kosovës, por me një

individ, duke aluduar te Kurti. Ku po e dërgon Kurti Kosovën?

Daniel Fried: Do të ishte më mirë që Kurti të ndërmernte një hap prapa dhe të gjente një mënyrë që do t'i riparonte raportet me ShBA-në. Çdo drejtim tjetër mund të bëhet shumë më i kushtueshëm. Nuk e di se çfarë mbështetjeje ka brenda Kosovës, nëse shihet si ai që i ka thyer marrëdhëniet me ShBA-në, e cila, para së gjithash, ishte e para në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës dhe sigurisë në Kosovë.

Shumë në Kosovë pyeten se pse vetëm Kosova ndëshkohet, jo Serbia...

Daniel Fried: Kjo ka të bëjë, sipas të gjitha gjasave, me besimin e keq në Qeverinë e Kosovës. E thashë, burimi themelor i problemit është në Beograd. Që Shtetet e Bashkuara të jenë aq të zemëruara me Qeverinë e Kosovës, këtu duhet të ketë ndodhur një akt i keqbesimit. Nuk e di me siguri, por është supozimi im.

Si do ta vlerësonit qasjen e administratës amerikane ndaj Kosovës dhe Serbisë?

Daniel Fried: Mendoj se para këtij shpërthimit të fundit, SHBA-ja e konsideronte problemin në Beograd dhe besonte se kosovarët, gradualisht, mund të dilnin në një gjendje relativisht të mirë. Por, asaj i duhet një partner në Kosovë për ta ndihmuar në stabilizimin e veriut. Mendoj se administrata amerikane ndjen se nuk e ka atë partner tani.

A mendoni se situata në veri mund të ketë një ndikim më të gjerë në rajon?

Daniel Fried: Sigurisht. Nuk ka asgjë të mirë që del prej kësaj. Do të ishte keq nëse çon në një konflikt të hapur, mendoj në përshkallëzim të tensioneve ose përshkallëzim të luftimeve dhe vdekje. Mendoj se Kurti duhet të veprojë shpejt për të vendosur së paku një marrëdhënie pune me administratën amerikane. Njerëzit bëjnë gabime. Këshilla ime do të ishte që t'i rregullojë ato, por nuk e di nëse jemi ende në atë pikë.

Sa përfiton aleatja e Serbisë, Rusia, nga kjo situatë?

Daniel Fried: Shumë. Ky është një lajm i mirë, i mirëpritur për Kremlinin dhe (ministrin e Jashtëm rus, Sergei) Lavrovin. Atyre u pëlqen t'i shohin Shtetet e Bashkuara duke u grindur me Kosovën. Do të jenë oportunistë dhe do ta shfrytëzojnë.

Çfarë do t'i sugjeronit Kurtit të bënte?

Daniel Fried: Të gjejë një mënyrë për të biseduar me Shtetet e Bashkuara pa zhurmë dhe të gjejë një mënyrë për t'u larguar nga ky konfrontim.

## Përfundon transferimi i ushtarëve turq në Kosovë

Prishtinë, 7 qershor - Ka përfunduar transferimi i një batalioni komando pas kërkesës së Komandës së Forcës së Përbashkët të NATO-s. Një pjesë tjetër e batalionit komando të Komandës së Brigadës 65 të Mekanizuar të Këmbësorisë e

vendosur në rrethin Luleburgaz të qytetit Kirklareli, e cila ishte caktuar si njësi rezervë, ka mbërritur në aeroportin ushtarak në Çorlu. Ushtarët turq pas përgatitjes në këtë vend, me avionë ushtarakë janë nisur drejt Aeroportit Ndërkombëtar

"Adem Jashari" në Prishtinë. Ushtarët janë pritur nga ambasadori turk në Prishtinë, Sabri Tunç Angli, ndërsa më pas kanë kaluar në kazermën "Sulltan Murat".

Rritja e numrit të ushtarëve të NATO-s në Kosovë vjen pas tensioneve në veri të vendit.







# Luftanije, nëndetëse, avionë: Ja si AMERIKA po përgatitet për luftë



“Mount witney” u nis drejt lindjes. Nisja e kësaj anije të ngadaltë amerikane vlen më shumë se aeroplanmbajtëset. Dhe i dërgon botës një mesazh të qartë: Amerika do t'i ketë duart e lira në krizën e sotme në Lindjen e Mesme.

“Mount Witney” është si një shtab lundruës. Është në gjendje të udhëheqë e vetme një konflikt të tërë. Ka ndodhur tashmë në 2011, kur e gjendur përballë

kundërshtimeve të qeverisë Berlusconi, ajo hyri në ujëra ndërkombëtare dhe drejtoi sulmet e parë në Libi.

Ajo që SHBA po bën në ujërat e Mesdheut tregon shqetësimin për atë që mund të ndodhë në orët e ardhshme. Nuk ka patur kurrë një skenar kaq të pasigurt, të mbushur me fronte të nxehtë dhe rreziqe pa fund për zgjerimin e luftës.

Brenda pak ditësh, pranë

brigjeve të Qipros do të vendosen 2 aeroplanmbajtëse, 2 kryqëzorë, 6 avionë gjuajtës, 1 task force e marinsave. Nga Skocia po vjen me nxitim një nëndetëse shumë speciale, “USS Florida” me 154 raketa Tomahawk”. Godasin deri 1000 km largësi.

Disa skuadronë avionësh gjuajtës janë vendosur në disa aeroporte të gadishullit arabik, dhe një grup i gatshëm zbarkimi gjendet

në kufijtë e Gjirit. Armata e Bidenit do të ketë në dispozicion dhjetëra luftanije, 200 avionë luftarakë, 5000 marinsa me mjete amfibe.

Ky demonstrim force ka mbi të gjitha qëllim parandalues. T'i tregojë Iranit pasojat e mundshme shkatërrimtare, në rast se fut hundët. Por edhe Hezbollahut, protagonist i përplasjeve në rritje në veri të Izraelit.

Jo më kot në Lindjen e Mesme janë dyfishuar avionët A-10, që shërbejnë për misione në lartësi të ulëta dhe kanë dhënë provat në betejat në Siri kundër Wagner-it rus.

Kryqëzorët në Mesdheun Lindor disponojnë raketat SM-6, të projektuara për të ndaluar raketa balistike edhe 350 km larg. Izraeli është totalisht nën kupolën e Marinës Amerikane. / bota.al

## “Salla e Luftës”: Aty ku Izraeli po punon për gjetjen e pengjeve që ka marrë Hamasi



Vendimi i militantëve të Hamasit për të filmuar sulmin e tyre të befashëm kundër Izraelit, u ka dhënë ekspertëve në sektorët e sigurisë kibernetike dhe ineligençës shumë prova për të punuar, në përpjekjet e tyre për të gjetur vendndodhjen e pengjeve që mbahen në Gaza.

“Shteti ka mjetet dhe informacionin, por ata nuk kanë aparatit për të punuar aq shpejt sa ne”, thotë Ido Har-Tuv, drejtori ekzekutiv i një agjencie marketingu që ka hapur një “Sallë Luftë” në zyrat e veta në periferinë e Tel Avivit, Ramat Hahayal, e cila konsiderohet Silicon Valley e Izraelit.


Shumë prej 100 burrave dhe grave në “Sallën e Luftës” kanë eksperiencë të madhe ushtarake dhe spiunazhi, dhe disa prej tyre po thirren prej njësisive elitare

ushtarake të Izraelit.

Platforma e grupit bazohet në teknologjinë më të fundit, përfshirë Inteligjencën Artificiale, për njohjen e fytyrave. Është një sistem i sofistikuar që kryqëzon imazhet e postuara nga militantët në mediat sociale me fotot e pengjeve, të postuara nga familjet. Kur ndodh një përputhje, sistemi mundet të gjejë vendndodhjen e përafërt të një personi të humbur. Më tej, ekspertët e inteligjencës gërrmojnë më tej, duke u bazuar në të dhëna rrethore si xhamitë, dyqanet apo këndi i diellit.

Ekipet kanë ndërtuar tashmë një bazë të dhënash prej afro 1000 personash, duke përfshirë pengje dhe pengmanrës. Ata e kanë ndarë platformën e tyre me zyrtarët izraelitë të sigurisë, të cilët do ta përdorin më tej për kërkimet e tyre.

# Poezia moderne është prozë (por ajo na thotë shumë)



Nga: Lawrence  
FERLINGHETTI  
Përktheu: Fadil BAJRAJ

Jam duke e shfletuar antologjinë e madhe të poezisë bashkohore, dhe m'u duk se "zëri ynë i brendshëm i madh" jehon më së shumti me zë proze, sado që i shtypur si poezi. Për atë s'mund të thuash se është prozaik ose se nuk ka thellësi, e as se është i vdekur ose se po vdes, ose që nuk është i bukur, ose se nuk është e shkruar mirë e me mendjehollësi dhe se nuk është e guximshme. Është shumë e gjallë, shumë mirë e shkruar, e dashur, prozë – prozë e gjallë që qëndron pa paterica të pikësimit, prozë, sintaksa e së cilës është aq e qartë sa që mund të shkruhet fund e krye faqes, në forma të hapura dhe fusha të hapura, dhe ende të jetë e qartë, prozë fort e dashur. Dhe, në tipografinë e poezisë, intelekti poetik dhe prozaik shfaqet në

probat e njëri tjetrit.

Duke shëtitur nëpër ngrehinat e prozës sonë në shekullin XXI, dikush mund të shikojë mbrapa dhe të çuditet me këtë epokë të çuditshme që i lejoi poezisë të ecë në ritmet e prozës dhe ende e quajti poezi. Poezia moderne është prozë sepse kumbon aq pushtueshëm sa çdo qytetar o qytetare, të cilëve elani i jetës u është zhytur në jetën urbane. Poezia moderne është prozë, sepse nuk ka duende, shpirt të errët të tokës dhe të gjakut, e as shpirt të këngës së errët, as të muzikës pasionuese. Ngjashëm si skulptura moderne, ajo e do betonin. Ashtu si arti minimal, ajo e minimizon ndjenjën për hatër të ironisë së heshtur dhe të intensitetit të nënkuptuar. Si e tillë është poezi e përsosur për njeriun teknokrat. Por, sa herë kjo poezi ngjitet mbi mesataren e lartësisë mbidetare të rrafshinës së tij shndritëse? Ezra Pound njëherë pat thënë se vetëm në kohën e dekadencës

poezia e ndan veten nga muzika. Dhe në këtë mënyrë bota merr fund, jo me këngë, por me rënkim.

Para tetëdhjetë ose nëntëdhjetë vitesh, kur të gjitha makinat filluan të zukas, gati (si dukej) në harmoni, fjala e njeriut pa dyshim pat filluar të bëhet e shtirë nga stakatoja absolute e makinave. Dhe, poezia e qytetit natyrisht se e imiton atë. Whitman ishte vazhdues, këndonte këngë për vetveten. Edhe Sandburg, një vazhdues, këndonte sagat e tij. Dhe, Vachel Lindsay ishte vazhdues, i tantaniste psalmet e tij. Dhe, më vonë ishte Wallace Stevens me "muzikën fiktive" të harmonishme. Ishte edhe Langston Hughes. Dhe Allen Ginsberg psalmonte mantrat e tij, këndonte Blakeun. Ka edhe të tjerë kudo, poetë xhazi dhe zhangëllmaxhinj poetikë, dhe vajtues rrugëve të botës, që bëjnë poezia nga e ngutshmja kryengritëse Tash, të vetës së

menjëhershme, inkarnimin e trupit të vet (siç e pat quajtur D. H. Lawrence).

Por, shumica e poezisë që zënë në rreshtat e nxehtë të linotipit dhe tani në tipat e IBM-it aq të ftohtë. S'ka këngë në mesin e daktilografëve, s'ka këngë në arkitekturën tonë prej betoni, në muzikën tonë prej betoni. E bilbilat ende mund të jenë duke kënduar pranë Manastirit të Zembrës së Shenjtë, vështirë se mund t'i dëgjojmë në qytetet e tokave të shkreta të T. S. Eliotit, e as Katër Kuartetet e tij (që s'mund të ekzekutohen në asnjë instrument dhe akoma është proza më e bukur e kohës sonë). E as në shkretëtirat e prozës së Ezra Poundit, të cilat nuk kanë kangjela, sepse s'mund të këndohen nga askush. As në prozën pangoline të Marianne Mooreit (e cila i quajti shkrimet e veta poezi në mungesë të shprehjes më të mirë). E as në prozën e madhe të vargut të bardhë në Ese mbi rimën të Karl

Shapiros, as në të folurit e brendshëm qytetarçe të William Carlos Williamsit, në të folurit e Petersonit të tij. Gjë që u duartrokoi nga profesorët e poezisë dhe kritikëve të poezisë në të gjitha vendet më të mira, e asnjëri nga ata s'do të bëjë mëkatën e parë e të thotë se poezia e disa poetëve është prozë e tipografuar si poezi – ashtu si, miqtë e poetit kurrë s'do t'i thoshin, ashtu si botuesit e poetit kurrë s'do ta thonë – konspiracioni më budallaq i heshtjes në historinë e shkronjave.

Pjesa më e madhe e poezisë moderne është prozë poetike por ajo na thotë shumë gjëra, me shembullin e vet, se çfarë na ofrojnë ne vdekja e shpirtit dhe qytetërimi ynë teknologjik, të ngatërruar në makina dhe maço nacionalizma, deri sa ne digjemi nga malli për bilbilin mes pishave të Reispighit, është kënga e zogut që na bën të lumtur. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Besa Famgas përfundon garimin në Kupën Evropiane

STAMBOLL, 22 TETOR - Kampionia e Kosovës në hendboll, Besa Famgas, e ka përfunduar garimin në Kupën Evropiane. Besa e

Pejë u ndal në raundin e dytë të Kupës Evropiane. Të shtunën në Stamboll, Besa u mposht nga gjiganti turk, Beshiktash, me rezultatin

40:28. Skuadra turke kishte fituar edhe në Pejë dhe avancoi tutje. Arbios Mushkolaj shënoi 9 gola për Besa Famgasin. 5 i

kishte Igor Chiseliov, ndërsa nga 4 i shënuan Jon Vokshi e Antonijo Vozila. 10 pritje i kishte Mursel Mehmeti.



# Drita fiton derbin në 'Zahir Pajaziti'

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 TETOR - Derbi i xhiros së dhjetë në Superligën e Kosovës në futboll i ka takuar skuadrën së Dritës nga Gjilani, pasi e mposhti të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti" skuadrën e Llapit me rezultat 0-1. Trajneri i Dritës, Akis Vavalis është shprehur shumë i lumtur me tri pikët e fituara në derbi dhe vazhdimin e ndeshjeve pozitive. "Fitore shumë e rëndësishme. Për mua secila fitore është e rëndësishme. Ndaj Llapit, në derbi, është fitore edhe më e rëndësishme. Në këtë moment më e rëndësishmja është që fituam tri pikë dhe që vazhduam serinë pozitive. Është dashur të krijojmë më shumë. Por as nuk jemi rrezikuar shumë. E rëndësishme ishte që të mos pësojmë, pasi e kemi ditur se kemi kualitetin për të shënuar gol", ka thënë Vavalis. Rastet në pjesën e parë nuk munguan nga të dyja skuadrat, por gola nuk pati. Në minutën e 81-të, Almir Ajzeraj arriti të shënon golin e parë në ndeshje dhe të

fitores për skuadrën e tij. Llapi u mundua të shënon golin për barazimit, por pa sukses. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina ka thënë se skuadra e tij nuk i shfrytëzoi rastet dhe kjo i kushtoi me humbje të ndeshjes. "Në pjesën e parë nuk i kemi shfrytëzuar rastet. Kur nuk i shfrytëzojmë rastet, vjen deri te pesimi. Në çdo aspekt kemi dominuar në të dy pjesët. Na kushtoi një pakujdesi. Ndoshta portieri ka mundur ta kapte topin. Pritej momenti për të dhënë golin dhe të fitojmë ndeshjen. Por në derbi vendosin detajet. Djemtë e kanë dhënë maksimumin", ka thënë Batatina. Drita renditet në vendin e dytë në tabelë me 21 pikë, derisa Llapi është i treti me 19 pikë. Skuadra e Dukagjinit ka bërë një rikthim të madh duke shënuar fitore me përmbysje ndaj Malishevës me rezultat 4-3. Altin Aliu shënoi golin e parë për mysafirët në minutën e 12-të, derisa Elom Nya-Vedji e dyfishoi epërsinë e Malishevës, pjesa e parë përfundoi me rezultat 2-0. Një gol i Santosit të Dukagjinit u anulua. Megjithatë mysafirët nuk u



dorëzuan dhe shënuan katër herë në pjesën e dytë për të marr pikët e plota. Zullfiji fillimisht zvogëloi rezultatin në 2-1, përpara se Junior të barazonte 2-2. Santos shënoi për epërsinë e parë të Dukagjinit 3-2, derisa Merkuaku shënoi për 4-2. Krejt çka arritën vendasit ishte goli i shënuar nga Hazrollaj për rezultatin 3-4. Malisheva mbetet në vendin e pestë, derisa

Dukagjini ngritet në të gjashtin. Të dielën janë zhvilluar dy ndeshje ku Gjilani ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me skuadrën e fundit në renditje, Fushë Kosovën, me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Kushtrim Shabani, në minutën e 67-të. Për Gjilanin ishte fitorja e tretë në këtë edicion, derisa për Fushë Kosovën kjo ishte

### SUPERLIGA - Java e 10-të

Llapi - Drita	0-1
Malisheva - Dukagjini	3-4
Feronikeli 74 - Prishtina	0-0
Gjilani - Fushë Kosova	1-0
Ballkani - Liria	4-1

Tabela		Pikë
1. Ballkani	9	23
2. Drita	9	21
3. Llapi	10	19
4. Prishtina	10	13
5. Malisheva	10	12
6. Dukagjini	10	12
7. Gjilani	10	11
8. Feronikeli 74	10	11
9. Liria	10	6
10. Fushë Kosova	10	5

humbja e shtatë në këtë edicion. Në ndeshjen tjetër, Prishtina ka arkëtuar vetëm një pikë si mysafire e Feronikelit. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" u mbyll pa gola (0-0). Kjo është ndeshja e shtatë radhazi që bardhekaltrit e kryeqytetit nuk arrijnë të gjejnë fitoren.

# Derbi i takon Prishtinës



PRISHTINË, 22 TETOR - Sigal Prishtina fitoi derbin e javës së pestë të Prince Caffè Superligës ndaj Bashkimit me rezultat 91:89 (27:21, 26:23, 21:23, 17:22). Kryeqytetasit e nisën ndeshjen dhe që në fillim kishin epërsi prej nëntë pikësh, 15:6 dhe ishin në epërsi gjatë çerekut të fundit, por me pesë pikë radhazi nga mysafirët, çereku i parë përfundon 27:21. Por, prishtinasit e nisën më mirë periudhën e dytë, duke shkuar në epërsi deri në 11 pikë, 43:32, derisa pjesa e parë përfundon 53:44. Megjithatë, pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë më mirë e nisën

prizrenasit që afrojnë shifrat në 55:52, por kryeqytetasit nuk lejuan përmbysjen, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 74:67. Në çerekun e fundit, Prishtina kishte epërsi deri në 14 pikë, 83:69, por Bashkimi nuk u dorëzua dhe luftoi deri në fund, duke afruar rezultatin minimalisht në 90:89, por nuk arriti përmbysjen e madhe dhe Sigal Prishtina triumfoi 91:89. Të vendasit u dalluan Derrick Wilson me 17 pikë, gjashtë kërcime e gjashtë asistime, Dardan Berisha me 20 pikë e gjashtë kërcime, kurse te mysafirët më i miri ishte Erik Copes me 25 pikë e 17 kërcime,

ndërsa Altin Morina shtoi 19 pikë e pesë asistime. Bardhekaltrit kanë katër fitore e një humbje, ndërsa Portokallezintë tri fitore e dy humbje. Trepça ka triumfuar në udhëtim ndaj United Basketball me rezultat 50:105 (17:25, 10:20, 8:29, 15:31). United Basketball e nisi me mirë se Trepça por që nuk e mbajti të njëjtën ritëm gjatë andaj çereku i parë përfundoi 17:25 për vajzat nga Mitrovica. Kurse në 10 minutat e çerekut të dytë, vajzat e United Basketball shënuan 10 pikë ndërsa pranuan 20. Epërsia më e madhe filloi në pjesën e tretë të ndeshjes ku Trepça shënoi 29

pikë kurse në anën tjetër United Basketball vetëm 8 pikë. Në pjesën e fundit të kësaj ndeshje vashat e drejtuara nga trajneri Demi u munduan për rikthim por që nuk mjaftoi duke u mposhtur me rezultat të thellë 50:105. Tek skuadra fituese më të mirat ishin, Mar'shay Moore me 50 pikë, 6 kërcime dhe 9 asistime ndërsa Jessica Wilson shtoi 27 pikë, 6 kërcime dhe 4 asistime. Më e dalluara tek United Basketball ishte Etna Rexhepi me 16 pikë e 11 kërcime. Për Trepçën kjo ishte fitorja e parë këtë edicion kurse United Basketball nuk ka arritur ende asnjë fitore.

## KH Trepça pëson për një gol, i mungon fati në fund

VOGOSHQA, 22 TETOR - KH Trepça është ndalur në raundin e dytë të Kupës Evropiane. Por skuadra mitrovicase ka luajtur dy ndeshje të forta dhe plotësisht të barabarta me Vogoshqan e Bosnjë-Hercegovinës. Të dy ndeshjet u luajtën në

Vogoshqa, që doli të jetë vendim i pa menduar mirë i klubit mitrovicas. Pas barazimit 27:27 të premtën, Trepça të dielën mbrëma pësoi 31:30 dhe u eliminua. Pjesa e parë i ka takuar skuadrës vendase, që krijoi epërsi deri në pesë gola. Pas 30 minutave

lojë rezultati ishte 18:14. Vendasit ishin në epërsi deri në minutën e 45-të, kur rezultati u barazua 25:25. Në minutën e 56-të, Trepça kaloi në epërsi 29:28, por pasoi një seri e mirë e pritjeve të portierit vendas, që mbajti në lojë Vogoshqan. Tri pritje rresht edhe vendosën

sfidën, duke mos lënë anash edhe disa vendime të dyshimta të gjyqtarëve në momentet vendimtare. Portierët e Vogoshqës i kishin 18 pritjet, ndërsa ata të Trepçës tetë dhe ky ishte ndryshimi kryesor. Deniz Terziqi ka shkëlqyer me 11 gola për



skuadrën mitrovicase. Shtatë i kishte Marley Wallace, ndërsa nga katër i shënuan Ron Ramadani e Lulzim Shabani.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarsva Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenet 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 2316/23 të datës 03.05.2023, zyrat përgjegjëse i nënshkruar në poshtë informon publikim për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikim të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:


Posta rekomandim:  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Njërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shikohet nga linku i mëposhtëm:

<http://www.pl-rka.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Telefon: + 381 38 200 32 222



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

-Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës Teknike "Nexhmedin Nixha".

Ujëvara Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e testit të maturës të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi".

Liberta Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

Edmonda Kadriu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Urimi Rent a car shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811430941.

Aksa Advertisement SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811284299.

Besart Sadiku B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810174673.

B2 SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit nr. 810129347.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi